

NGA KOPSHTI NË SHKOLLË: TA PLANIFIKOJMË KALIMIN SË BASHKU

Të dashur prindër,

në verë, fëmija juaj hyn në shkollë. Të jeni të sigurt, fëmija juaj do të mirëpritet në shkollë! Është e rëndësishme që fëmija juaj të vazhdojë të ketë kënaqësi gjatë të mësuarit dhe të qëndrojë kureshtar. Nëse fëmija juaj e ndjen që i besohen atij vetëm detyrat dhe aktivitetet, ai merr guxim dhe vetëbesim. Në këtë fletëpalosje ju gjeni informacione mbi mënyrën se si mund ta mbështesni fëmijën tuaj.

Këshilla të përgjithshme

Çdo fëmijë është i ndryshëm, pyesni në kopsht se ku i nevojitet ende mbështetje fëmijës suaj.

Përndryshe kemi sugjerimet e mëposhtme për ju:

- ▶ Vizitoni së bashku me fëmijën tuaj faqen kryesore të internetit të shkollës.
- ▶ Njihuni së bashku me fëmijën tuaj me rrugën e ardhshme të shkollës dhe hidhjani një sy shkollës. Vini re edhe tabelat dhe semaforët.
- ▶ Vendosni së bashku me fëmijën tuaj materialet shkollore, në këtë mënyrë ju zgjoni kënaqësinë paraprake e fëmijës suaj për shkollën.
- ▶ Pyesni nëse fëmija juaj e di emrin e tij të plotë, adresën dhe numrin e telefonit.

Këshilla për mbështetjen në përditshmëri

- ▶ Lëreni fëmijën tuaj që të vishet vetë, të hapë dhe të mbyllë zinxhirët dhe pullat dhe të lidhë lidhëset.
- ▶ Në jetën e përditshme, caktojini detyra të vogla fëmijës suaj, p.sh. të sjellë diçka ose të nxjerrë diçka jashtë.
- ▶ Fëmija juaj mund t'ju ndihmojë në punët e shtëpisë, p.sh. gjatë gatimit, pjekjes dhe gjatë përgatitjes së tavolinës.
- ▶ Lëreni fëmijën tuaj që t'i pastrojë vetë gjërat e tij.
- ▶ Mbështetni orientimin në hapësirë, p.sh. kur fëmija juaj bën blerje të vogla
- ▶ Lëreni fëmijën tuaj të lëvizë shumë, mundësisht jashtë: të ngjisë shkallët,

të kacavaret, të mbajë ekuilibrin, të ecë mbrapsht me majë të gishtave, të luajë futboll, të kërcejë.

- ▶ Mbështeteni fëmijën tuaj të përqendrohet 15 minuta në një gjë. Inkurajojeni t'i çojë deri në fund detyrat dhe lojërat.
- ▶ Lavdërojini fëmijën tuaj edhe për përparime të vogla.
- ▶ Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë programe televizive dhe flisni së bashku për to. Kufizojeni kohën për mediat (televizion, kompjuter, smartfon, Playstation, etj.) deri në 30 minuta në ditë.
- ▶ Mbështeteni fëmijën tuaj që të mësojë një sjellje të duhur dhe me respekt.

Dhe nëse mbetet ende kohë gjatë ditës

- ▶ Luani lojëra sociale (p.sh. lojëra me zar, Memory, Puzzle)
- ▶ Lexojini atij libra dhe lëreni që fëmija juaj të tregojë historinë
- ▶ Të këndojë këngë
- ▶ të presë, të brumosë, të pikturojë, të ngjyrosë, të ngjisë, të palosë
- ▶ T'i ndajë gjërat sipas madhësisë dhe t'i përshkruajë

Shkollat dhe kopshtet në StädteRegion Aachen ju mbështesin në këtë kohë të vështirë dhe i urojnë fëmijës suaj një fillim të mbarë në shkollë.

Impressum

Herausgeber: StädteRegion Aachen, A 43 Bildungsbüro

Telefon: 0241/5198-4315

E-Mail: bildungsbuero@staedteregion-aachen.de

Homepage: www.staedteregion-aachen.de/elpri

Stand: Januar 2021

Redaktion

Steuergruppe „Übergang Elementar-/Primarbereich“, Kommunales

Integrationszentrum StädteRegion Aachen

Viele Inhalte des Flyers finden Sie auch in Elternflyern aus Würselen, Baesweiler, Alsdorf, Kohlscheid, Simmerath sowie im Flyer von „Trans KiGs“ und „Startklar“ Broschüre.